



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA

Emërtimi i modulit: PËRKTHIM TEKNIK NË FUSHËN E LEGJISLACIONIT TË BE-SË (KSHK 7, Kualifikim për të nxënëit gjatë gjithë jetës 3, Programet e studimeve të formimit të vazhduar)

Programi i Formimit të Vazhduar : “PËRKTHIM TEKNIK, LETRAR DHE INTERPRETIM”

Lloji i Trajnimit: Trajnim i drejtpërdrejtë në prezencë / online

Titullari /pedagogu i lëndës:

Gjuha e përdorur në mësimdhënie/provime: “Gjuha e burimit” anglisht, frëngjisht, italisht, gjermanisht, greqisht, spanjisht, turqisht, rusisht, shqip.

“Gjuha e synuar” anglisht, frëngjisht, italisht, gjermanisht, greqisht, spanjisht, turqisht, rusisht, shqip

Ngarkesa: 3 ECTS

Kohëzgjatja : 30 orë;

PËRMBLEDHJE DHE REZULTATET E TË NXËNIT:

Kursi fokusohet në përkthimin e legjislacionit të Bashkimit European nga e huaj në atë shqipe dhe anasjelltas. Mbulon parimet themelore të përkthimit ligjor, terminologjisë ligjore të BE-së, teknikat përkthimore dhe ushtrime praktike bazuar në tekste ligjore. Kursi përmban gjithashtu edhe një analizë krahasimore të sistemeve ligjore dhe punëtori për sfidat përkthimore. Pjesë e kursit është edhe mënyra e hartimit të ligjeve, gramatika e përdorur dhe dallimi i shenjave të pikësimit.

Objektivat:

Në përfundim të kursit studentët:

- do të zhvillojnë më tej aftësitë e tyre në përkthimin e terminologjisë ligjore nga gjuha e huaj në atë shqipe (dhe anasjelltas) brenda konteksteve ligjore të BE-së;
- do të jenë familjarizuar me strukturën dhe terminologjinë e legjislacionit të BE-së për sa i përket legjislacionit primar dhe sekondar);
- do të lundrojnë lehtësisht në bazat e të dhënave ligjore shumëgjuhëshe (EUR-Lex, IATE);
- do të njohin më mirë dallimet strukturore mes traditës së “common law” dhe të drejtës civile
- do të përkthejnë dokumente me fuqi ligjore si direktiva, rregullore, kontrata dhe vendime gjyqësore.

KONCEPTET THEMELORE:

Ky kurs synon:

- të paraqesë metodologjinë e punës së zbatuar në praktikën e përkthimit;
- të trajtojë çështjen:
 - e zbatimit të teknikave përkthimore;
 - të studimit të përftesave përkthimore;
 - e analizimit në këndvështrim krahasues.